



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.886/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Skender Shala dhe me bashkëpunëtorin profesional Blerim Istrefi, ne çështjen juridike te paditësit **Q.I** nga te cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. A.D nga, kundër te paditurës Komuna e -, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore, me dt.26.04.2019 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Q.I nga Mitrovica dhe, **OBLIGOHET** e paditura Komuna e t'ia paguajë paditësit Q.I nga, në emër te pagesës për shpërblim jubilar pas pensionimit si mësimdhënës te e paditura për 30 vjet te përvojës se punës ne vlerë te 1 page bazë, shumën prej 456.65 €, dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej 1,369.95 €, respektivisht shuma totale prej 1,826.06 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III.OBLIGOHET e paditura Komuna e t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 279 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes te autorizuarit te tij me datë 13.11.2018 ka ushtruar padi e te precizuar për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te një page jubilar dhe 3 pagave përcjellëse me rastin e pensionimit duke u bazuar ne nenin 35 par.8 dhe 9 te Kontratës Kolektive te Arsimit te Kosovës.

Gjykata, me dt. 23.04.2019 ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, si dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditësit në seancë të shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbesim në tersi pran padis dhe kërkesëpadisë së parashtruar, beje preciz imin e të njëjtës ashtu që në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të dt. 18.04.2017 kërkoj nga gjykata që padia e paditësit të aprovohet në lartësi të katër pagave dhe atë të një page jubilarë dhe tri përcjellëse, kurse nga kamata heqim dorë. Me tutje i autorizuari i paditësit shton se rroga mesatare e paditësit para daljes në pension ka qen shuma prej 456.65 €, shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkoj sipas tarifës së avokateve.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë të shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për arsyeje të mjeteve buxhetore, mirëpo të njëjtën kohë nuk e kundërshtoj nxjerrjen e provave, po ashtu nuk e kontestoj faktin se paditësi ka punuar për periudhën e pretenduar në padi, po ashtu nuk është kontestuese as lartësia e pagës së paditësit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Vendimi i dt. 05.10.2017 mbi njohjen e të drejtës mbi pension bazik lëshuar nga MPMS Departamenti i Pensioneve në emër të paditësi, Vërtetimi mbi përvojën e punës të paditësit i dt.15.07.2008 lëshuar nga SHM- Gjimnazi për periudhën kohore 01.09.1977-31.08.1984, Vërtetimi mbi përvojën e punës të paditësit i dt.15.07.2008 lëshuar nga SHM- Gjimnazi për periudhën kohore 01.09.1984-31.08.1985, Vërtetimi mbi përvojën e punës të paditësit i dt.05.11.2018 lëshuar nga SHM- Gjimnazi për periudhën kohore 01.09.1990-05.10.1998, Vërtetimi nr.463 të dt. 07.11.2018 mbi përvojën e punës së paditësit të lëshuar nga SHMT për periudhën kohore 06.11.1998-21.09.1999, 04.09.2007-31.08.2008 dhe 01.09.2009-08.09.2017, Njoftimi- Përgjigja e të paditurës së dt. 05.03.2018, Pasqyra bankare lëshuar nga ProCredit Bank e dt. 06.11.2018, dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Faktet jo kontestuese:

Fillimisht paditësi para ngritjes së padis ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë të dt. 13.03.2018 për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse pas pensionimit, ndërsa e paditura me datë 15.03.2018 e ka njoftuar paditësin se sipas Ligjit të Punës nuk janë paraparë kompensime të tilla, ndërsa dispozitat e

Kontratës Kolektive nuk janë obligative për punëdhënësin, kjo vërtetohet nga përgjigja në kërkesë e dt.15.03.2018.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qene në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënës për me tepër se 30 vite, ky fakt u vërtetua nga këto prova: Vërtetimi mbi përvojën e punës të paditësit i dt.15.07.2008 lëshuar nga SHM- Gjumnazi për periudhën kohore 01.09.1977-31.08.1984, Vërtetimi mbi përvojën e punës të paditësit i dt.15.07.2008 lëshuar nga SHM- Gjumnazi për periudhën kohore 01.09.1984-31.08.1985, Vërtetimi mbi përvojën e punës të paditësit i dt.05.11.2018 lëshuar nga SHM- Gjumnazi për periudhën kohore 01.09.1990-05.10.1998, Vërtetimi nr.463 të dt. 07.11.2018 mbi përvojën e punës së paditësit të lëshuar nga SHMT për periudhën kohore 06.11.1998-21.09.1999, 04.09.2007-31.08.2008 dhe 01.09.2009-08.09.2017.

Nuk është kontestues se paditësit i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension të pleqërisë me dt.08.09.2017, e kjo vërtetohet nga Vërtetimi nr.463 të dt. 07.11.2018 mbi përvojën e punës së paditësit të lëshuar nga SHMT

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 456.65 €, ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë e lëshuar nga nga ProCredit Bankë e dt. 06.11.2018 në emër të paditësit e datës 06.11.2018 për periudhën 31.05.2017 deri me 30.08.2017.

Me vendimin e MPMS Depërtomani i Pensioneve të dt. 05.10.2017 paditësit ju ka njohur e drejta në pension kontributiv në shumë prej 172 €,

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesës padisë, iu referua nenit 35 par. 8 nën par. 8.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 e cila parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar për 30 vjet të përvojës në vlerë të 1 page bazë” dhe nenit 35.9 të po të njëjtës kontratë i cili parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësit e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës bankare të dt. 06.11.2018, se paditësi ka marrë tri pagat e fundit në vlerë prej 456.65 €.

Prandaj, gjykata bazuar në nenit 35 par. 8 nën par. 8.3 dhe nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e

shumës së përgjithshme prej 1,826.06 €, dhe atë në emër të tri pagave
përcjellëse shumën prej 1,369.95€,
dhe në emër të shpërblimit jubilar (1 page bazë) shumën prej 456.65 €.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 €, 104 € ne emër te përpilimit te padis dhe 40 € ne emër te taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.886/2018 datë 26.04.2019

GJYQTARI
Skender Shala

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.